



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.521/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE-ve “Con-Des SH.P.K & NNP Euro Contruction & Jetmiri” SH.P.K - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të riijnë - Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë”, më datën: 03.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik: “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të riijnë - Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të riijnë - Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “AC Ing & AAG Projekt ” SH.P.K - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.07.2020 me nr. 521/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Con-Des SH.P.K & NNP Euro Contruction & Jetmiri” SH.P.K - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të riijnë- Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave ” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, si dhe nenin 108/A të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.08.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 14.08.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimin nr.1, Lidhur me pretendimin e grupit të OE “AC Ing” Sh.p.k & “AAG Projekt” Sh.p.k - Prishtinë, se AK gjatë fazës së rivlerësimit ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit OE: “Con-Des” Sh.p.k; NNP Euro Construction” & “Jetmiri” Sh.p.k edhe pse një anëtar i këtij grupi ka dorëzuar vërtetimin tatimor të datës 09.06.2020 në emrin “Bislim Morina” B.I me nr. fiskal 810740945 në të cilin rezulton që ky OE aktualisht është në marrëveshje me këste për shlyerjen e borxheve, që sipas OE ankues nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe LPP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Pas rekomandimit për kontratë nga komisioni i rivlerësimit të ofertës së grupit të OE “Con-Des” Sh.p.k;

NNP “Euro Construction” & “Jetmiri” Sh.p.k, AK konform kërkesës së dosjes së tenderit ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë të dorëzoj deklaratat e vërtetimit tatimor të ATK-së për të gjithë anëtarët e konzorciumit. Eksperti shqyrtues sqaron se vërtetimi tatimor i dt. 09.06.2020 i dorëzuar nga anëtari i konzorciumit “Bislim Morina” B.I rezulton në marrëveshje me këste me ATK-në për shlyerjen e borxheve. Konform LPP-së, interpretimit të KRPP-së dhe pretendimit ankimor të OE ankues me datë 10.08.2020 përmes e-mailit kam kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë marrëveshjen në mes të anëtarit të konzorciumit “Bislim Morina” B.I dhe ATK-së për shlyerjen e borxheve me këste. Me dt.11.08.2020 nga OE i rekomanduar për kontratë kam pranuar tri dëshmi (deklarata) të vërtetimit tatimor që i përkasin anëtarit të konzorciumit “Bislim Morina” B.I.

1. Vërtetimin tatimor të datës 14.01.2020 në të cilin rezulton që OE “Bislim Morina”B.I nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore. Ky vërtetim i përket datës 14.01.2020 që është pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë (09.12.2019) që nënkupton që deri në datën publikimit të njoftimit për kontratë ky OE nuk ka qenë me vonesë në pagesën e obligimeve ndaj ATK-së.

2. Marrëveshjen për pagesë të borxheve tatimore me këste në mes të OE “Bislim Morina” B.I dhe ATK-së të datës 08.06.2020.

3. Vërtetimin tatimor të datës 10.08.2020 në të cilin rezulton që OE Bislim Morina” B.I nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore dhe ka përmbyllur marrëveshjen e datës 08.06.2020 për pagesën e borxheve me këste ndaj ATK-së.

Bazuar në interpretimin e KRPP-së sipas të cilit OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jetë i pranueshëm.

Eksperti shqyrtues konsideron se vërtetimet tatimore të anëtarit “Bislim Morina” B.I janë koform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në datën e publikimit të njoftimit të kontratës ky OE nuk ka qenë me vonesë në pagesën e obligimeve ndaj ATK-së, por borxhet dhe marrëveshja me këste për shlyerjen e obligimeve janë të periudhës pas publikimit të njoftimit të kontratës, andaj ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2, Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se deklarata mbi themelimin e grupit dhe deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit “Jetmiri” Sh.p.k nuk janë nënshkruar nga pronari Sadik Heta ose personi i autorizuar Ramiz Heta siç është kërkuar dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në deklaratën mbi themelimin e grupit dhe deklaratën nën betim të anëtarit të grupit “Jetmiri” Shpk, si përfaqësues i këtij OE është prezantuar z. Ramiz Heta i cili në certifikatën e biznesit të OE “Jetmiri” Sh.p.k figuron si drejtor- Agjent i regjistruar. Eksperti shqyrtues sqaron se deklaratat e anëtarit “Jetmiri” Sh.p.k janë të nënshkruara nga z. Ramiz Heta dhe nënshkrimi është i njëjtë në të dy deklaratat që është konform kërkesës

së dosjes së tenderit. Nuk është në kompetencë dhe përgjegjësi të ekspertit shqyrtues të trajtoj nëse ky nënshkrim është autentik i z. Ramiz Heta apo ndonjë personi tjetër. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimin 3, Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se Aneksin 6. të dosjes së tenderit nuk e kanë plotësuar të gjithë anëtarët e grupit të OE të rekomanduar për kontratë "Con-Des" Sh.p.k; NNP "Euro Construction" & "Jetmiri" Sh.p.k, eksperti shqyrtues sqaron se dy anëtarët e konzorciumit kanë plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit që ka të bëjë me kontratat dhe referencat e realizuara në tri vitet e fundit. Sipas LPP-së nuk është obligative që të gjithë anëtarët e konzorciumit të prezantojnë listën e kontratave dhe referencave të realizuara (neni 68 dhe 69 i LPP-së), do të mjaftonte që vetëm njëri nga anëtarët e grupit të dorëzonte listën e kontratave dhe referencave të realizuara nëse kjo listë e përmbush vlerën prej 800,000.00 € siç është kërkuar në dosje të tenderit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimin 4, Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se grupi i OE "Con-Des" Sh.p.k; NNP "Euro Construction" ; "Jetmiri" Sh.p.k nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3 (tri) vitet e fundit, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në ekspertizën e kaluar dhe në vendimin e Panelit Shqyrtues, PSH.nr.259/20 të datës 12.06.2020, citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues, i cili ka konstatuar se konzorciumi ankues e plotëson kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, konkretisht dëshmitë në lidhje me referencat-procesverbalet e pranimeve teknike dhe listën e kontratave në vlerë 800,000.00 €, vjen në përfundim se OE ankues është eliminuar padrejtësisht sepse i njëjti e ka plotësuar kërkesën në lidhje kapacitetin teknik dhe profesional". Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 5, Sa i përket pretendimit të OE ankues se menaxheri i kontratës është caktuar vetëm nga lideri i grupit dhe pa logo të partnerëve, eksperti shqyrtues sqaron se në kërkesën e dosjes së tenderit është kërkuar vetëm se OE duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional: Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë (menaxher i projektit) dhe autorizimi i liderit të grupit "Con-Des" Shpk për caktimin e inxhinierit të ndërtimtarisë z.Berat Murati si menaxher të kontratës nuk është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit. Në dosje të tenderit nuk është specifikuar se menaxheri i kontratës duhet të ofroj referenca të përvojave specifike por vetëm është kërkuar Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt dhe dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë për menaxherin e kontratës janë konform kërkesës së dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 6, Sa i përket pretendimit të OE ankues se deklaratat e qarkullimit financiar të grupit të OE; “Con-Des” Shpk; NNP “Euro Construction” ; “ Jetmiri” Sh.p.k nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit qe sipas OE ankues anëtar i grupit “Jetmiri” Sh.p.k të gjithë aktivitetin e ka prodhim dhe projekte të infrastrukturës dhe nuk duhet të merren si qarkullim sepse kërkesa e dosjes së tenderit është për ndërtime të larta, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 1,000,000.00 euro e dëshmuar me Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore te Kosovës ose 2. Kopjet e raporteve financiare te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

Eksperti shqyrtues sqaron se deklaratat e qarkullimit financiar(ATK) të dorëzuara nga grupi i OE “Con-Des” Shpk; NNP “Euro Construction”;“Jetmiri” Sh.p.k tejkalojnë vlerën prej 1,000,000.00€ dhe deklaratat e qarkullimit financiar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit. Në dosje të tenderit nuk është kërkuar deklarata e qarkullimit financiar sipas aktiviteteve specifike por vetëm është kërkuar qarkullimi vjetor financiar në tri vitet e fundit. Andaj, pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK ka bërë rivlerësimin e tenderëve konform vendimit të Panelit Shqyrtues, PSH. nr. 259/20 të datës 12.06.2020 dhe nenit 59 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me lidhjen e kontratës.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 14.08.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 14.08.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë: 17.08.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 03.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë, se AK gjatë fazës së rivlerësimit ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit OE: “Con-Des” Sh.p.k; NNP Euro Construction” & “Jetmiri” Sh.p.k edhe pse një anëtar i këtij grupi ka dorëzuar vërtetimin tatimor të datës 09.06.2020 në emrin “Bislim Morina” B.I me nr. fiskal 810740945 në të cilin rezulton që ky OE aktualisht është në marrëveshje me këste për shlyerjen e borxheve, që sipas OE ankues nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas rekomandimit për kontratë nga komisioni i rivlerësimit të ofertës së grupit të OE “Con-Des” Sh.p.k; NNP “Euro Construction” & “Jetmiri” Sh.p.k, AK konform kërkesës së dosjes së tenderit ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë të dorëzoj deklaratat e vërtetimit tatimor të ATK-së për të gjithë anëtarët e konzorciumit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se vërtetimi tatimor i datës 09.06.2020 i dorëzuar nga anëtari i konzorciumit “Bislim Morina” B.I rezulton në marrëveshje me këste me ATK-në për shlyerjen e borxheve. Konform LPP-së dhe interpretimit të KRPP-së, si dhe pretendimit ankimor të OE ankues, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues me datë 10.08.2020 përmes e-mailit ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë marrëveshjen në mes të anëtarit të konzorciumit “Bislim Morina” B.I dhe ATK-së për shlyerjen e borxheve me këste. Me dt.11.08.2020, OE i rekomanduar për kontratë i ka kthyer përgjigje ekspertit shqyrtues duke i dërguar tri dëshmi (deklarata) të vërtetimit tatimor që i përkasin anëtarit të konzorciumit “Bislim Morina” B.I., konkretisht vërtetimin tatimor të datës 14.01.2020 në të cilin rezulton që OE “Bislim Morina” B.I nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore. Ky vërtetim i përket datës 14.01.2020 që është pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë (09.12.2019) që nënkupton që deri në datën publikimit të njoftimit për kontratë ky OE nuk ka qenë me vonesë në pagesën e obligimeve ndaj ATK-së. Dokumenti tjetër është marrëveshja për pagesë të borxheve tatimore me këste në mes të OE “Bislim Morina” B.I dhe ATK-së të datës 08.06.2020, si dhe dokumenti i tretë është vërtetimi tatimor i datës 10.08.2020, në të cilin rezulton që OE Bislim Morina” B.I nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore dhe ka përmbyllur marrëveshjen e datës 08.06.2020 për pagesën e borxheve me këste ndaj ATK-së. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të interpretimit të KRPP-së, sipas të cilit OE i “pranueshëm” ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit, borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se vërtetimet tatimore të anëtarit “Bislim Morina” B.I janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në datën

e publikimit të njoftimit të kontratës ky OE nuk ka qenë me vonesë në pagesën e obligimeve ndaj ATK-së, por borxhet dhe marrëveshja me këste për shlyerjen e obligimeve janë të periudhës pas publikimit të njoftimit të kontratës.

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë se deklarata mbi themelimin e grupit dhe deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit “Jetmiri” Sh.p.k nuk janë nënshkruar nga pronari Sadik Heta ose personi i autorizuar Ramiz Heta siç është kërkuar dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në deklaratën mbi themelimin e grupit dhe deklaratën nën betim të anëtarit të grupit “Jetmiri” Shpk, si përfaqësues i këtij OE është prezantuar z. Ramiz Heta i cili në certifikatën e biznesit të OE “Jetmiri” Sh.p.k figuron si drejtor- Agjent i regjistruar. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se deklaratat e anëtarit “Jetmiri” Sh.p.k janë të nënshkruara nga z. Ramiz Heta dhe nënshkrimi është i njëjtë në të dy deklaratat që është konform kërkesës së dosjes së tenderit. Nuk është në kompetencë dhe përgjegjësi të OSHP-së që të trajtoj nëse ky nënshkrim është autentik i z. Ramiz Heta apo ndonjë personi tjetër.

Lidhur me pretendimin e tretë të OE ankues “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë se Aneksin 6. të dosjes së tenderit nuk e kanë plotësuar të gjithë anëtarët e grupit të OE të rekomanduar për kontratë “Con-Des” Sh.p.k; NNP “Euro Construction” & “ Jetmiri” Sh.p.k.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se dy anëtarët e konzorciumit kanë plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit që ka të bëjë me kontratat dhe referencat e realizuara në tri vitet e fundit. Sipas LPP-së nuk është obligative që të gjithë anëtarët e konzorciumit të prezantojnë listën e kontratave dhe referencave të realizuara (neni 68 dhe 69 i LPP-së), do të mjaftonte që vetëm njëri nga anëtarët e grupit të dorëzonte listën e kontratave dhe referencave të realizuara nëse kjo listë e përmbush vlerën prej 800,000.00 € siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues se grupi i OE “Con-Des” Sh.p.k; NNP “Euro Construction” ; “ Jetmiri” Sh.p.k nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3 (tri) vitet e fundit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar më herët në vendimin e Panelit Shqyrtues, PSH.nr.259/20 të datës 12.06.2020, ku është konstatuar se e plotëson kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, konkretisht dëshmitë në lidhje me referencat-procesverbalet e pranimeve teknike dhe listën e kontratave në vlerë 800,000.00€.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “AC Ing & AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë se menaxheri i

kontratës është caktuar vetëm nga lideri i grupit dhe pa logo të partnerëve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në kërkesën e dosjes së tenderit është kërkuar vetëm se OE duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional: Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë (menaxher i projektit) dhe autorizimi i liderit të grupit “Con-Des” Shpk për caktimin e inxhinierit të ndërtimtarisë z.Berat Murati si menaxher të kontratës nuk është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit. Në dosje të tenderit nuk është specifikuar se menaxheri i kontratës duhet të ofroj referenca të përvojave specifike por vetëm është kërkuar Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt dhe dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë për menaxherin e kontratës janë konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e gjashtë të OE ankues se deklaratat e qarkullimit financiar të grupit të OE “Con-Des” Shpk; NNP “Euro Construction” ; “ Jetmiri” Sh.p.k nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit qe sipas OE ankues anëtar i grupit “Jetmiri” Sh.p.k të gjithë aktivitetin e ka prodhim dhe projekte të infrastrukturës dhe nuk duhet të merren si qarkullim sepse kërkesa e dosjes së tenderit është për ndërtime të larta.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 1,000,000.00 euro e dëshmuar me Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose 2. Kopjet e raporteve financiare të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Lidhur me këtë kërkesë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se deklaratat e qarkullimit financiar (ATK) të dorëzuara nga grupi i OE “Con-Des” Shpk; NNP “Euro Construction”; “Jetmiri” Sh.p.k tejkalojnë vlerën prej 1,000,000.00€ dhe deklaratat e qarkullimit financiar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit. Në dosje të tenderit nuk është kërkuar deklarata e qarkullimit financiar sipas aktiviteteve specifike por vetëm është kërkuar qarkullimi vjetor financiar në tri vitet e fundit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna në vendimin paraprak të OSHP-së, po ashtu AK ka pasur parasysh edhe kërkesat e dosjes së tenderit me rastin e vlerësimit të tenderit duke vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast

ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerim Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "Komuna Prishtinë" (KK.P) ,
- 1x1 OE " AC Ing & AAG Projekt " SH.P.K - Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.